



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KOMUNA E DRENASIT**

**DREJTORATI PËR ARSIM**



**ME DATË: 12.10.2022, NR. 09/111-52400**

---

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në Nenin 79 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe bazuar në Nenin 7, 12,13,14,15 të Rregullores me nr. 320-19338, dt. 07.04.2017 të Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glllogocit) për kushtet , kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregulloren më nr. 02-400/01- 18380 te datës 27.04.2022 për ndryshim dhe plotësim të rregullores për ndarjen e subvencioneve, Drejtori i Drejtoratit për Arsim,shpall:

### **KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE**

### **PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË DRENASIT**

Komuna e Drenasit ndanë dyqind (200) bursa për studentët e kësaj komune që studiojnë në universitetet publike të Kosovës në vitin akademik 2022/2023 në të gjitha fakultetet apo drejtimet e studimit (megjithëse vetëm studentët e disa fakulteteve marrin pikë bonus). Vetëm studentët e rregullt të nivelit Baçelor kanë të drejtë konkurrimi për fitimin e bursës komunale. Dyqind bursa do të ndahen për studentët e nivelit Baçelor, me mundësi të rritjes se numrit të përfituesve të bursës varsishtë sa buxhet sigurohet prej Komunës dhe donatorëve. Lartësia e bursës komunale për një student është pesëqind (500) euro.

#### **Kushtet për konkurrim për bursë komunale**

Kandidati duhet:

1. Të jetë banor i Komunës së Drenasit.
2. Të jetë student i rregullt në vitin akademik 2022/2023 në ndonjërin nga universitetet publike të Kosovës ( Viti i I deri në vitin VI të studimeve ).
3. Të jetë student i nivelit Baçelor.
4. Të mos ketë përsëritur (humbur) vitin akademik.
5. Të mos jetë në marrëdhënie pune me pagesë me orar të plotë.
6. Të mos jetë përfitues i bursave tjera për vitin përkatës akademik.

## Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të bursave komunale

Përzgjedhja e përfituesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat/e bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme. Nëse një kandidat/e bie në më shumë se një nga kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati). Nëse kandidatët mbesin me pikë të barabarta do të veprohet si më poshtë: **Studentët me pikë të barabarta në rënditjen përfundimtare do të rënditen më notën mesatare më të lartë, nëse notat mesatare janë të njejta do të shkohet në bazë të rënditjes alfabetike.** Kriteret dhe kategoritë janë të renditura në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Kriteri/Kategoria   | Pikët |
|-----|---|-------|
| 1   | Nota mesatare në studime prej notës 9.51 deri 10.00   | 40    |
|     | Nota mesatare prej notës 9.01 deri 9.50   | 30    |
|     | Nota mesatare prej notës 8.01 deri 9  | 20    |
|     | Nota mesatare prej notës 7.01 deri 8  | 10    |
|     | Nota mesatare prej notës 6 deri 7   | 5     |
|     | Për studentët e vitit të parë pa nota – më deftesën shkëlqyeshëm e klasës XII   | 40    |
|     | Për studentët e vitit të parë pa nota – më deftesën shumë mirë e klasës XII   | 30    |
| 2   | Student bonjak (pa të dy prindërit)   | 10    |
| 3   | Student me nevoja të veçanta  | 10    |
| 4   | Student nga familja me ndihmë sociale   | 10    |
| 5   | Student – fëmijë i dëshmorit të UÇK-së  | 10    |
| 6   | Student – fëmijë i invalidit të luftës së UÇK-së  | 5     |
| 7   | Student – fëmijë i veteranit të luftës së UÇK-së  | 5     |
| 8   | Student që ka edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtari tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoratë) | 5     |
| 9   | Student të drejtiveve deficitare  | 5     |

Të gjitha statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante, siç përshkruhet më poshtë.

### **Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente**

#### **Të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në DKA) ose shkarkohet nga faqja e komunës.
- Dokumenti personal (letërnjoftim).
- Ekstrakti i lindjes ose Certifikata e lindjes.
- Kartela Identifikuese e studentit.
- Vërtetimi nga universiteti publik (fakulteti apo departamenti përkatës) se kandidati është student i rregullt në nivelin e studimeve Bachelor në vitin përkatës të studimeve, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve, që kandidati e ka të regjistruar vitin akademik 2022/2023 dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik.
- Certifikata e notave të studimeve (kandidatët që janë në vitin e parë të studimeve Bachelor dhe që nuk kanë nota në studime duhet të sjellin dëshmi nga fakulteti që ende nuk kanë nota dhe duhet të sjellin Certifikatën e notave të klasës së fundit të shkollës së mesme të lartë.
- Pasqyra e llogarisë nga Trusti pensional deri në datën e nxjerrjes.
- Vërtetim se nuk është përfitues i bursës studentore për vitin përkatës akademik.

#### **Kandidatët që bien në kategoritë tjera të sipër-përshkruara në tabelë duhet të dorëzojnë:**

- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 1 – Certifikata e notave për vitin përkatës të studimeve.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 2 – certifikatat e vdekjes së të dy prindërve.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 3 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 4 – vërtetimi i nxjerrur në Qëndren për Punë Sociale ( orgjinal ).
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 5, 6 dhe 7 – vërtetimi i nxjerrur nga shoqatat e dalura nga lufta ( orgjinal ).
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 8 – Certifikata familjare dhe vërtetimi (motër, vëlla, prind, fëmijë) që është student i rregullt.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 9 – për çdo vit akademik do të merret një shkresë zyrtare në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës për drejtimet deficitare.

### **Sqarime shtesë:**

Të gjitha dokumentet që dorëzohen me rastin e aplikimit duhet të jenë kopje ( përjashtim në origjinal sipas kriterit 4,5,6 dhe 7 në tabelen e lartëcekur ) dhe ato nuk kthehen, nëse ka diqka kontestuse në kopjet e dukumentacioneve do të kërkohen origjinalet për t'u konfirmuar të dhënat vetëm për kandidatët që përzgjidhen si përfitues të bursave.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

### **Afati dhe mënyra e aplikimit:**

Konkursi është i hapur prej datës: **13 Tetor 2022 deri më 27 Tetor 2022.**

Aplikacionet pranohen çdo ditë pune prej orës 09:00 – 15:00. Përfituesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në Komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e Komunës së Drenasit.

Drenas,  
Më:12.10.2022

 Dretor për Arsim  
Muhamet Gjoka